



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 146, Datë 19.07.2024

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “NOVA PROSPECT” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1448/5 prot., datë 17.07.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “Nova Prospect” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Nova Prospect” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1448 prot., datë 03.06.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 22960, Njësia Administrative Pilur, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 123, datë 19.06.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.06.2024 dhe 21.06.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 01.07.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu me shkresën nr. 1558 prot., datë 27.06.2024, ERE ka njoftuar dhe MIE-n mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie.

- Me shkresën me nr. 1448/3 prot., datë 24.06.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo plotësuar pjesërisht.
- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1448/4 prot., datë 03.07.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, rezulton se shoqëria duhet të dokumentojë në ERE mënyrën e shlyerjes së vlerës së mbetur të investimit, si dhe të depozitojë njoftimin që i është bërë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në lidhje me ndryshimin e vlerës së investimit dhe qëndrimin e saj për këtë, në rast se ka pasur një të tillë.
- Në nenin 14, pika 3 të Rregullores parashikohet se: Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.
- Me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme me shoqërinë për të sqaruar informacionin/dokumentacionin që ka mbetur ende për t’u plotësuar dhe depozitimin e tij në vijim në ERE, vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Nova Prospect” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë këtë informacion/dokumentacion në ERE brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Nova Prospect” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit brenda 20 (njëzet) ditëve.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Nova Prospect” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI